

## Procesverbal

I mbajtur sot me datë 31.07.2023, në sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Kukës .

U zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Kukës , bazuar në ligjin 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore “ dhe Rregulloren për organizimin e funksionimin e Këshillit Bashkiak si dhe njoftimin përkatës.

Në mbledhje morën pjesë: Albert Muja, Edmond Hallaçi, Sami Mata, Gazmend Oruçi, Republika Tusha, Arjeta Zela, Astrit Dobrushit, Vashe Dida, Xhem Visha, Rubin Omuri, Destan Spahiu, Ervis Gjana, Erjon Brati, Valion Muja, Bledar Lleshaj, Gazmend Oruçi, Aurora Guska, Astrit Cengu, Hume Elezaj, Armida Rexhaj, Adelina Shllaku, Bajr Bajra, Halim Peca, Arjan Cengu, Lumturije Gjuta,

Pasi thirret prezenca e anëtarëve pjesëmarrës dhe konfirmohet kuorumi, deklarohet hapja e mbledhjes në orën 10:26.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Albert Muja lexon rendin e ditës.

- 1.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 09.06.2023, 23.06.2023 dhe 07.07.2023.
2. Miratimi i raportit të Komisionit të Mandateve për deklarimin e mbarimit të mandatit para afatit për 1 anëtar të Këshillit Bashkiak.
3. Miratimi i raportit të Komisionit të Mandateve për dhënien e mandatit për 1 anëtar të Këshillit Bashkiak.
4. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, Qershor 2023”.
5. Projektvendim “Për miratim fondi për dhënie pagese me rastin e daljes së punonjësve në pension pleqërie”.
- 6.Projektvendim “ Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve PBA 2024-2026”.
7. Projektvendim “ Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari përfaqësues I Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut Kukës.

Hidhet në votim rendi i ditës. Miratohet me 16 vota pro, 4 kundër, të tjerat abstenim.

Aurora Guska: Nisur nga disa denoncime në portale vendore se në administratën vendore dhe qendrore janë punësuar njerëz që nuk paraqiten në punë, madje shumë prej tyre nuk kanë as vendbanimin në Bashkinë Kukës, kërkoj nga administrata ( Drejtoria përkatëse për burimet njerëzore) të vini në dispozicion të Këshillit Bashkiak strukturën e Bashkisë Kukës, Listën emërore të punonjësve, pozicionet e tyre të punës dhe vendbanimet.

Fillon shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

Aurora Guska, në cilësinë e kryetares së Komisionit të mandateve, lexon para këshillit 2 raportet e hartuara nga ky komision për dhënien e mandatit zj. Vashe Dida (PAA) si dhe heqjen e mandatit zj. Blerona Potja (NTH).

Miratohen raportet e Komisionit të Mandateve.

Vijohet me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 09.06.2023, 23.06.2023, 07.07.2023.

Astrit Cengu: - Në mbledhjen e konstituimit i është dhënë mandate dhe ka marrë pjesë në votim zj. Blerona Potja e cila është punonjëse bashkie.

Rubin Omuri:- Le të verifikohet.

Hume Elezaj: Në mbledhjen e konstituimit votimi I anëtarëve përfaqësues në Këshillin e Qarkut është bërë nën presion. Duhej të vijohesh mbledhja për zgjedhjen e përfaqësuesit të katërt dhe jo të ndërpritej.

Aurora Guska: Ligji parashikon që në votimin për zgjedhjen e përfaqësuesve në Këshill qarku të mos ishte present Kryetari i Bashkisë dhe Prefekti i Qarkut. Jo vetëm që ishin present por Prefekti ka ndërhyrë në mbledhje duke dhënë mendime. Gjithashtu, fletët e votimit nuk duhej të ishin plotësuar me shkrim dore.

Nuk ka kundërshtime të tjera. Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 09.06.2023, 23.06.2023, 07.07.2023 me 5 vota kundër.

Shqyrtohet pika 4. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, Qershor 2023”.

Sami Mata:- Për muajin qershor 2023 përfitojnë 473 familje.

Gazmend Hallaçi: Në tabelat që na janë sjellë me email janë 431 familje. Pse?

Asllan Bilali:- Lexon nr. e përfituesve sipas njësive administrative. Janë në total 473 familje përfituese. Nuk ka diskutime të tjera. Miratohet ndihma ekonomike me të gjitha votat pro.

Shqyrtohet pika 5. Projektvendim “Për miratim fondi për dhënie pagese me rastin e daljes së punonjësve në pension pleqërie”.

Sami Mata: - Projektvendimi është miratuar unanimisht në komision. Ju ftoj ta votoni.

Hume Elezaj:- A mund t'i japim 2 paga punonjësës pasi është një grua pa fëmijë dhe bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë?

Ramiz Hereni: Ligji parashikon deri në 1 pagë.

Hidhet në votim. Miratohet me të gjitha votat pro.

Shqyrtohet pika 6. Projektvendim “ Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve PBA 2024-2026”.

Sami Mata:- Projektvendimi jep informacion të qartë për tavanet e shpenzimeve për PBA 2024-2026. Është konform ligjeve dhe vendimeve të mëparshme të Këshillit Bashkiak.

Komisioni e ka kaluar. Ju ftoj ta votoni.

Hidhet në votim. Miratohet me 3 vota abstenim dhe të gjitha të tjerat pro.

Albert Muja:- Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës Projektvendim “ Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari përfaqësues I Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut Kukës. Miratohet ngritja e komisionit të votimit me 3 anëtarë.

Propozohen si anëtarë të komisionit të votimit:

1. Aurora Guska (proponuar nga Hume Elezaj)
2. Hume elezaj (proponuar nga Aurora Guska)
3. Destan Spahiu (proponuar nga rubin Omuri)

Miratohet përbërja e komisionit.

Fillohet me propozimet për kandidatët përfaqësues të Këshillit Bashkiak në Këshillin e qarkut.

Armida Rexhaj propozon Gazmend Oruçin.

Destan Spahiu propozon Valion Mujën.

Ndërpritet mbledhja për 10 minuta derisa komisioni të bëjë përgatitjet e nevojshme.

Rifillon mbledhja. Vjen në mbledhje edhe Lumturije Gjuta.

Komisioni vulos fletët e votimit. Fillon votimi. Komisioni thërret sipas radhës anëtarët e Këshillit për të votuar. Votojnë: Halim Peca, Gazmend Hallaçi, Lumturije Gjuta, Republika Tusha, Albert Muja, Adelina Shllaku, Arjeta Zela, Astrit Dobrusha, Xhem Visha, Vashe Dida, Bajr Bajra, Erjon Brati, Astrit Cengu, Arjan Cengu, Sami Mata, Gazmend Oruçi, Armida Rexhaj, Edmond Hallaçi, Ervis Gjana, Bledar Lleshaj, Rubin Omuri, Valion Muja, Destan Spahiu, Hume Elezaj, Aurora Guska.

Votuan gjithsej 25 anëtarë.

Komisioni fillon numërimin e votive dhe konstaton:

Fletë votimi Gjithsej: **25**

Fletë votimi të vlefshme: **24**

Fletë votimi të pavlefshme: **1**

Nga këto:

Gazmend Oruçi- **13 vota**

Valion Muja: **11 vota**

Komisioni firmos procesverbalin përfundimtar dhe konstaton se asnjë prej kandidatëve nuk e kalon pragun 50% + 1 të votive të vevojshme.

Mbyllet mbledhja në orën 12:11.

Firmoset procesverbali i mbledhjes.

**Kukës, 31.07.2023**